



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 18 mars 2010
Ref. Nr. AGJ 07/10

Aktgjykim

Lënda Nr. KO 01/09,

Qemajl Kurtishi

Dhe

Kuvendi Komunal i Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Gjykata Kushtetuese, e përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Robert Carolan, Gjyqtar
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Iliriana Islami, Gjyqtar
Kadri Kryeziu, Gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar dhe
Altay Suroy, Gjyqtar

Pas shqyrtimit të kërkesës së Z. Qemajl Kurtishi, Zëvendës Kryesues për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, lëshon këtë AKTGJYKIM si në vijim:

Hyrje

Parashtruesi

Kopje e vërtetuar
Overena kopija
Certified Copy

1. Parashtruesi i kërkesës është Z. Qemajl Kurtishi, Zëvendës Kryesues për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Republika e Kosovës.

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Kuvendi i Komunës së Prizrenit, Republika e Kosovës.

Data e parashtrimit të Kërkesës

3. Kërkesa është parashtruar në Gjykatën Kushtetuese më 22 prill 2009.

Data e gjykimit

4. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur dëgjim publik në lidhje me këtë rast më 30 nëntor 2009.

Shqyrtimi i Gjykatës

5. Gjykata shqyrtoi rastin në seancë të mbyllur më 27 janar 2010.

Përmbledhje e Procedurës

6. Qemajl Kurtishi, Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ka parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës më 22 prill 2009. Z. Kurtishi pretendon se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit shkel nenet 3.1, 6.1, 58.1 dhe 59.1 të Kushtetutës. Më 4 gusht 2009, Gjykata Kushtetuese ka informuar Komunën e Prizrenit mbi parashtrimin e kërkesës nga Z. Kurtishi, si dhe i ka kërkuar Komunës t'i përgjigjet kërkesës. Kryetari i Kuvendit Komunal dhe Kryetari i Komunës i janë përgjigjur kërkesës më 2 tetor 2009.
7. Kryetari i Gjykatës emëroi¹ Gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar Raportues dhe u themelua Kolegji Shqyrtues në përbërje të Gjyqtarëve Altay Suroy, Snezhana Botusharova dhe Ivan Cukalovic. Më 7 tetor 2009, Parashtruesit të kërkesës i është kërkuar të qartësojë dhe plotësojë kërkesën duke qartësuar se si dhe pse shkelja e pretenduar ka qenë jokushtetuese, në çfarë kapaciteti ka nënshkruar ai kërkesën, si dhe për të ofruar dëshmi mbi pozitën e tij në Komunën e Prizrenit. Z. Kurtishi u përgjigj më 12 tetor 2009, duke dhënë informatat e kërkuara. Më 12 nëntor 2009, Gjyqtari Rodrigues dorëzoi raportin për shqyrtim nga Kolegji Shqyrtues. Më 26 nëntor 2009, Kolegji Shqyrtues u mblodh për të shqyrtuar raportin e Gjyqtarit Raportues. Më 30 nëntor 2009 u mbajt dëgjimi publik. Z. Kurtishi u paraqit në emër të tij personal; Komuna e

¹ Në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenit 7 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese

Prizrenit nuk ishte e përfaqësuar. Gjykata u mbledh më 27 janar 2010, në një seancë të mbyllur për të shqyrtuar lëndën.

Paraqitja e fakteve dhe deklarimi i argumenteve të palëve

8. Z. Kurtishi i ka ofruar Gjykatës Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, të datës 11 shtator 2008, të nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës, në të cilën theksohej: "Ne deklarojmë se Zëvendës Kryesuesi për Komunitete në Kuvendin Komunal të Prizrenit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, është Z. Qemaj Kurtishi, jurist i diplomuar". Të njëjtit zyrtarë të Kuvendit të Komunës, në përgjigjen e tyre në kërkesë, nuk kanë ushtruar ndonjë kundërshtim ndaj statusit të Z. Kurtishi paraqitur me kërkesën dhe lëndën e tij në Gjykatën Kushtetuese. Kështu, Gjykata Kushtetuese gjen që Z. Kurtishi ka pozitën dhe autoritetin e duhur ligjor për ta parashtruar këtë kërkesë Gjykatës Kushtetuese.
9. Z. Kurtishi ka parashtruar kërkesën e tij² si Zëvendës Kryesues për Komunitete në Komunë, duke qenë person i autorizuar për t'i referuar aktet apo vendimet e Komunës të cilat pretendohen se i kanë shkelur të drejtat e tyre para Gjykatës Kushtetuese.
10. Nenet 54 dhe 55 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale parashikojnë si në vijim:

Neni 54

Zëvendës-kryesuesi i komuniteteve

54.1 Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo-shumicë, posti i zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve.

54.2 Postin e zëvendës-kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo-shumicë, që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në kuvendin e komunës.

Neni 55

Detyrat e zëvendës-kryesuesit të Kuvendit të komunës për komunitete

55.1 Zëvendës-kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete i komunës promovon dialog ndër-komunal dhe shërben si pikë qendrore zyrtare për

² Në bazë të nenit 55.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligji nr. 03/L-040, në rast se komuna zgjedh të mos shqyrtojë aktet apo vendimet që shkelin të drejtat e komuniteteve të garantuara me kushtetutë të cilat janë referuar nga Zëvendës kryesuesi, ai apo ajo mund ta parashtrtojë çështjen drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese.

adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në mbledhjet e kuvendit.

55.2 Zëvendës-kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të komuniteteve apo pjesëtarëve të tyre, në mënyrë që aktet apo vendimet e kuvendit të komunës të mos i shkelin të drejtat e garantuara kushtetuese të tyre.

55.3 Zëvendës-kryesuesi i kuvendit të komunës për komunitete, aktet apo vendimet e tilla ia paraqet kuvendit të komunës për rishqyrtim.

55.4 Në rast se kuvendi i komunës nuk e shqyrton aktin apo vendimin, ose zëvendës-kryesuesi i Kuvendit të komunës konsideron se rezultati, pas rishqyrtimit, ende paraqet shkelje të të drejtave të garantuara kushtetuese, ai mund ta parashtrojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese e cila mund të vendosë për pranimin e çështjes për shqyrtim.

11. Më 15 tetor 2008, Komuna e Prizrenit³, miratoi Vendimin për miratimin e Statutit Komunal. Neni 7 i këtij Statuti parashikon:

Neni 7

Komuna ka emblemen, flamurin dhe simbolin e saj.

Emblema e Komunës është "Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit", e rrethuar me fjalët në vijim "1878 – Prizren".

Përdorimi i simboleve komunale do të rregullohet më tutje me një vendim të veçantë të Kuvendit.

12. Kërkesa e dorëzuar nga Z. Kurtishi thekson që komunitetet jo-shumicë në atë kohë kishin propozuar që fjalët "Komuna", "Opstina", "Belediye" të shkruhen brenda rrethit të emblemes, pa vitin "1878", duke simbolizuar kështu që ka disa komunitete që jetojnë në hapësirën e komunës, si dhe që Komuna është shumetnike. Ai propozim nuk ishte pranuar. Për më tepër, ai pretendon që anëtarët e Kuvendit të Komunës nga komuniteti shumicë kishin injoruar faktin e pranisë tradicionale të komuniteteve jo-shumicë në Komunë. Z. Kurtishi pretendon që paraqitja dhe simboli i Lidhjes së Prizrenit lartëson identitetin e vetëm njërit komunitet në Komunën e Prizrenit. Ai thekson se Lidhja e Prizrenit njih vetëm rëndësinë kulturore-historike të komunitetit shqiptar, dhe që emblema nuk ka elemente të cilat tregojnë komunitetet tjera që jetojnë në Komunë. Ai pretendon që emblema komunale duhet të simbolizojë dhe transmetojë porosinë e bashkëjetesës së komuniteteve dhe pjesëtarëve të komuniteteve, si dhe praninë e etnive të shumta, kulturave të shumëfishta, fetë e shumta dhe gjuhët e shumta. Emblema, deklaron ai, nuk dërgon

³ Në bazë të nenit 12.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr. 03/L-040

porosinë e shumetnicitetit në vetë hapësirat shumetnike siç janë ato të Komunës së Prizrenit.

13. Z. Kurtishi vazhdon të deklarojë që simboli nuk është miratuar nga shumica e Kuvendit me dy të tretat (2/3)⁴. Ai thekson që vetëm 24 nga 41 anëtarë të Kuvendit kanë votuar për miratimin e Vendimit në fjalë. Në fakt, neni 7.4 parashikon si në vijim:

7.4. Simbolet e komunës mund të miratohen apo ndryshohen me votat e shumicës me dy të tretat (2/3) e Kuvendit të Komunës, pasi të jenë mbajtur konsultime të gjera publike.

14. Megjithatë, përgjigja e Komunës thekson se më 15 tetor 2008, 29 anëtarë të Kuvendit kanë votuar për propozimin, ndërsa 5 kundër tij. Pa marrë parasysh këtë konflikt të dukshëm mes Z. Kurtishi dhe Komunës mbi numrat e votave pro dhe kundër miratimit të Vendimit mbi Statutin, kjo Gjykatë nuk vendos për bazat që burojnë nga parregullsia e pretenduar në procedurën e votimi, prandaj, asgjë nga ky Aktgjykim nuk mund të merret si në favor apo në kundërshtim të kësaj pjese të kërkesës.
15. Z. Kurtishi, në pjesën materiale të kërkesës së tij, ngre një numër bazash të ndryshme ligjore si bazë e kërkesës së tij. Ai pretendon se është shkelur neni 3 i Kushtetutës. Neni 3 përcakton:

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

16. Së dyti, ai thekson se është shkelur Neni 4.3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Neni 4.3 i këtij Ligji parashikon si në vijim:

4.3. Komunitatet i zbatojnë politikën dhe praktikën e tyre për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të tyre dhe për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjithë komuniteteve për t'i shprehur, ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore.

⁴ Në bazë të nenit 7.4 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji nr. 03/L-040

17. Në vazhdim, ai thotë se janë shkelur nenet 1.1, 1.4 dhe 2.1 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë⁵. Në këtë fazë, është me rëndësi të citohen nenet 1 dhe 2 të atij ligji në plotësinë e tyre.

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1 Republika e Kosovës garanton barazi të plotë dhe efektive për të gjithë popullin e Kosovës. Kosova e konsideron shumëllojshmërinë e saj kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare si një burim force dhe pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike që bazohet në sundimin e ligjit. Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, inkurajohet dhe çmohet kontributi aktiv i të gjithë personave që iu përkasin komuniteteve.

1.2 Republika e Kosovës ndërmerr masat e veçanta për të siguruar barazi të plotë dhe efektive për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, duke marrë në konsideratë nevojat e tyre të veçanta. Këto masa nuk konsiderohen si akt diskriminimi.

1.3 Personat që iu përkasin komuniteteve në Republikën e Kosovës kanë të drejtë t'i gëzojnë individualisht apo së bashku me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut që janë përcaktuar në obligimet ligjore ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Kosovës. Këto të drejta dhe liri garantohen me kushtetutë, me ligje, rregullore dhe politika tjera shtetërore.

1.4 Për qëllimet e këtij ligji, komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare tradicionalisht të pranishme në Republikën e Kosovës të cilat nuk janë shumicë. Këto grupe janë komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran dhe komunitete të tjera. Pjesëtarët e komunitetit shumicë në Republikën e Kosovës, të cilët si tërësi nuk janë shumicë në një komunë të caktuar po ashtu i gëzojnë të drejtat e radhitura në këtë ligj.

1.5 Çdo person që i takon një komuniteti ka të drejtë që lirisht të zgjedhë të trajtohet apo të mos trajtohet si i tillë dhe asnjë dëm apo diskriminim nuk do të rezultojë nga zgjedhja e ushtrimit apo jo të të drejtave të cilat lidhen me këtë zgjedhje.

1.6 Gjatë ushtrimit të lirë nga ana e tyre të të drejtave dhe lirive të mbrojtura me këtë ligj, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre i respektojnë të drejtat e të tjerëve.

⁵ Ligji nr. 03/L-047

1.7 Autoritetet në Republikën e Kosovës, përfshirë gjykatat, e interpretojnë këtë ligj në pajtim me garancitë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të përcaktuara në Kushtetutën e Kosovës, në obligimet e aplikueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë dispozitat e Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Përcaktuar Kombëtare.

Neni 2

Identiteti

2.1 Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që lirisht të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre dhe të ruajnë e përmirësojnë elementët esencialë të identitetit të tyre, veçanërisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë e tyre kulturore. Përveç të drejtave të posaçme të numëruara në këtë ligj, të drejtat themelore të njeriut do të ushtrohen lirshëm dhe në mënyrë të barabartë, duke përfshirë lirinë e të menduarit, të shprehurit, të mediave, të shoqërimit dhe tubimit; të besimit dhe ushtrimit të fesë dhe të drejtën e manifestimit privatisht ose publikisht, individualisht apo në komunitet me të tjerë të attributeve kulturore të komunitetit përkatës.

2.2 Republika e Kosovës do të krijojë kushtet e duhura për t'iu mundësuar komuniteteve dhe personave që iu përkasin komuniteteve që lirshëm të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë identitetet e tyre.

2.3 Ndalohen masat që synojnë ndryshimin e strukturës së popullatës, në zonat e banuara nga personat që iu përkasin komuniteteve e që janë në dëm të tyre. Republika e Kosova gjithashtu do t'i mbrojë personat që iu takojnë komuniteteve, nga politikat apo praktikatat që kanë për qëllim ose kanë ndikim në asimilimin kundër dëshirës së tyre.

2.4 Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë që t'iu njihen emrat e tyre personalë në formën e tyre origjinale, në formën e shkruar në gjuhën e tyre, si dhe t'i rikthejnë emrat e tyre origjinale, nëse janë ndryshuar. Kjo përfshin të drejtën për të zgjedhur lirshëm emrat dhe mbiemrat e tyre, si dhe emrat e fëmijëve të tyre, dhe të drejtën për t'i regjistruar këta emra në regjistrat civil, në dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e tjera zyrtare, në gjuhën dhe shkrimin e tyre, në përputhje me ligjin.

18. Z. Kurti si më tutje pretendon që në kohën e miratimit të Statutit, Komiteti i Komuniteteve nuk ishte në gjendje të shqyrtonte Statutin dhe Vendimin në fazën e hartimit, përkundër faktit që anëtarët e Komitetit të Komuniteteve kishin insistuar për domosdoshmërinë e shqyrtimit nga ana e tyre. Kështu,

pretendon ai, është shkelur neni 53 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Ky nen përcakton si në vijim:

Neni 53

Komiteti i Komuniteteve

53.1 Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

53.2 Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

19. Përfundimisht, thekson Z. Kurtishi, në kuptimin e përgjithshëm janë shkelur nenet 6, 58⁶ dhe 59.1⁷ të Kushtetutës. Gjykatës nuk është paraqitur ndonjë arsyetim mbi atë se si janë shkelur këto nene.
20. Në përgjigjen e saj, Komuna e Prizrenit kundërshton kërkesën e parashtruar nga Z. Kurtishi në tërësinë e saj. Komuna pretendon që për miratimin e Statutit të Komunës kanë votuar në favor numri i duhur e i nevojshëm. Komuna thekson që më 10 nëntor 2008, vendimi i Kuvendit të Prizrenit i është dërguar Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për vlerësimin e detyrueshëm të ligjshmërisë.
21. Ata pranojnë që më 27 nëntor 2008, MAPL-ja i rekomandoi Kuvendit Komunal rishqyrtimin e nenit 7 të Statutit. Pas kësaj, ata theksojnë se në një takim të mbajtur më 20 shkurt 2009, Kuvendi miratoi vendimin duke

⁶ Neni 58 1. Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.

⁷ Neni 59 (1) Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

(1) të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatesisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;

rikonfirmuar nenin 7 të Statutit. Po ashtu ata theksojnë se më 16 mars 2009, MAPL-ja i dërgoi Kuvendit Komunal mendimin ku konstatohet se "vendimi i sipërpërmendur është lëshuar në pajtim me procedurat ligjore, d.m.th. me nenin 7 të Statutit Komunal, si dhe me nenin 7.4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe në pajtim me kërkesën e Ministrit të MAPL-së për shqyrtimin e nenit 7 të Statutit Komunal të miratuar 15.10.2008." Duket se ky mendim i MAPL-së tregon se të gjitha çështjet janë adresuar si duhet nga ana e Komunës dhe se çdo gjë ishte në rregull me Statutin e Komunës së Prizrenit dhe se shqetësimet fillestare të MAPL-së janë trajtuar

22. Qysh më 27 nëntor 2008, Komunës i ishte bërë me dije që ekzistonte një shqetësim, në nivel tejet të lartë, mbi miratimin e nenit 7 të Statutit Komunal. Ishin ngritur pyetje të rëndësishme mbi nivelin e duhur të konsultimit të gjerë publik dhe obligimet e Komunës për të marrë parasysh konsultimet e tilla. Komuna është dashur të mendonte seriozisht se do t'i trajtonte konsultimet e tilla në pajtim me obligimet e saj para Ligjit, në lidhje me simbolin e Komunës, e sidomos në kuptimin e brengave që ishin ngritur nga komunitetet e komunës.
23. Sa i përket nenit 3.1 të Kushtetutës, Komuna thekson që nuk ka pasur shkelje, sepse asnjë pakicë nuk është favorizuar para një pakice tjetër. Komuna nuk qartëson se si veprimet e Komunës do të mund të kishin pasur efektin e përjashtimit të komuniteteve në Komunën e Prizrenit.
24. Sa i përket nenit 6 të Kushtetutës, Komuna thekson që asnjë shkelje sipas këtij neni nuk qëndron, sepse ai vlen vetëm për Simbolet Shtetërore të Kosovës. Thuhet që Z. Kurtishi nuk ka bërë ndonjë ankesë për Simbole Shtetërore të Kosovës, dhe si e tillë, nuk mund të paraqesë shkelje të nenit 6.
25. Sa i përket shkeljeve tjera të pretenduara të Kushtetutës dhe Ligjit, Komuna thekson se ato "nuk qëndrojnë". Komuna kërkon që kërkesa e Z. Kurtishi të refuzohet si e pabazë. Në asnjë mënyrë thelbësore, Komuna nuk trajton shqetësimet që sa i përket shkeljes së të drejtave të pakicave të parashtruara me kërkesën e Z. Kurtishi, si dhe të cilat përmbliidhen në paragrafët paraprak.

Arsyetimi dhe justifikimi

26. Është me rëndësi të theksohet pushteti dhe funksionet e kësaj Gjykate. Dispozitat kryesore të Kornizës Gjithëpërfshirëse për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës kanë propozuar dispozita kushtetuese, ekonomike dhe të sigurisë, dhe të gjitha këto kanë synuar të kontribuojnë në zhvillimin e një Kosove shumetnike, demokratike dhe përparimtare. Për Kosovën ishte propozuar një shoqëri shumetnike, e vetëqeverisur në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, si dhe me nivelin më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore njerëzore të pranuar ndërkombëtarisht. Sa i përket të drejtave të

komuniteteve. Zgjidhja duhej të trajtonte aspektet kryesore që duheshin mbrojtur, duke përfshirë kulturën, gjuhën, arsimin dhe simbolet.

27. Kuvendi i Kosovës miratoi Kushtetutën më 9 prill 2008. Ajo hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Doktrina e ndarjes së pushtetit në lidhje me ushtrimin e pushtetit gjyqësor merr jetë nga Kushtetuta⁹, e cila qartësisht thotë që një pushtet i tillë ushtrohet nga Gjykatat. Gjykatat janë të obliguara të gjykojnë lëndët që i paraqiten në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Nënkuptohej që Gjykata është tërësisht e pavarur dhe duhet që jetë tërësisht e paanshme gjatë kryerjes së funksioneve të saj. Kushtetuta¹⁰ në mënyrë të qartë përcakton kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Organet e caktuara, duke përfshirë individët, mund të referojnë çështje në Gjykatë apo edhe shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë¹¹ nga ana e autoriteteve publike. Kompetencat shtesë mund të përcaktohen me ligj.
28. Mbetet të Gjykata që, si *"autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën"*¹² të vlerësojë nëse ligjet apo statutet janë në pajtim me Kushtetutën. Prandaj, ajo do të bëjë përcaktime për shkeljet nga ana e autoriteteve publike të të drejtave dhe lirive individuale të garantuara me Kushtetutë, *"mirëpo vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuar me ligj"*¹³. Kjo do të thotë se organet shtetërore dhe Gjykatat, gjatë marrjes së vendimeve të tyre, janë të obliguar që të veprojnë brenda kornizës kushtetuese. Për të qenë në pajtueshmëri me këtë obligim, ekzistojnë palët e autorizuar për të referuar çështje të caktuara para Gjykatës¹⁴. Në anën tjetër, *"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit"*¹⁵ dhe ato *"kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese"*¹⁶, duke pasur parasysh të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese.
29. Organet shtetërore *"do të garantojnë të drejtat e çdo qytetari, liritë civile dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit ..."*¹⁷ Neni 3 i Kushtetutës përcakton:

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

⁸ Siç shprehet me nenin 4 të Kushtetutës

⁹ Në nenin 102

¹⁰ Neni 113 and Neni 62.4

¹¹ Duke përfshirë të drejtat e përcaktuara me Konventat Ndërkombëtare, të numëruara në nenin

22.

¹² Neni 112 (1) i Kushtetutës

¹³ Neni 113 (7) i Kushtetutës

¹⁴ Neni 113 i Kushtetutës

¹⁵ Neni 102 (3) i Kushtetutës

¹⁶ Neni 113 (8) i Kushtetutës

¹⁷ Preambula e Kushtetutës

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

30. Përgjatë gjithë Kushtetutës ekzistojnë referenca ndaj parimeve të barazisë dhe shumetnicitetit, për shembull, në përshkrimin e karakterit shumetnik të simboleve shtetërore të Kosovës¹⁸, në trajtimin e vlerave bazë¹⁹, në trajtimin e barazisë para ligjit²⁰, në trajtimin e barazisë para gjykatave²¹ dhe shumë pjesë tjera.
31. Kushtetuta është ligji bazë i vendit, si dhe është burimi i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve dhe komuniteteve të Kosovës²². Këto të drejta themelore janë "të pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme si dhe janë baza e rendit juridik të Republikës së Kosovës"²³. Veç kësaj, Kapitulli 3, përcakton më tutje "Të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre"²⁴. Këto të drejta të mëtutjeshme të Komuniteteve plotësojnë, zgjerojnë dhe shtojnë gjitha të drejtat tjera të shprehura në Kushtetutë.

¹⁸ Në nenin 6. 1. Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumetnik të saj.

¹⁹ Në nenin 7. 1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. 2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

²⁰ Në nenin 24. 1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

²¹ Në nenin 31.1 Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

²² Të drejtat themelore trajtohen në Kapitullin 2 të Kushtetutës, i cili përbëhet nga nenet 21 deri 56

²³ Siç përcaktohet në nenin 21.1 të Kushtetutës

²⁴ Kapitulli 3, në nenet 57 deri 62.

32. Neni 57.3 i Kushtetutës shprehimisht i jep Anëtarëve të Komuniteteve "...të drejtën e shprehjes së lirë, nxitjes dhe zhvillimit të identitetit dhe attributeve të komuniteteve të tyre." Një nga mënyrat që komunitetet "shprehin, nxisin dhe zhvillojnë identitetin dhe atributet e tyre" është përmes angazhimit në procesin politik, duke marrë parasysh në shqyrtimin e miratimit të Statutit të Komunës, si dhe duke dhënë sugjerime konstruktive për formën e emblemës që Komuna zgjedh të miratojë. Neni 58.4 obligon Republikën e Kosovës të "...miratojë masa adekuate që janë të nevojshme për të promovuar, në gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, barazinë e plotë dhe efektive të komuniteteve". Ky obligim mbulon edhe Komunën e Prizrenit si të buruar nga Shteti, duke pasur njohjen kushtetuese si një prej njësive themelore të qeverisjes lokale. Neni 124.1 obligon Komunën e Prizrenit, dhe gjitha komunat, "...të inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të gjithë qytetarëve në procesin e vendim-marrjes nga organet komunale."
33. Për më shumë, neni 22 i Kushtetutës, ka përfshirë në të drejtën kushtetuese të Kosovës, si dhe e ka bërë drejtpërdrejt të zbatueshëm, një trup thelbësor të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore. Ky nen parashikon:

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
 - (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
 - (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
 - (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
 - (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
 - (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
 - (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
 - (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.*
34. Këto Konventa pra kanë zbatueshmëri të drejtpërdrejtë në Kosovë, si dhe kanë përparësi mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Vendimet që dalin nga tribunalet që vendosin në bazë të këtyre

Konventave, fillimisht Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg, ndihmojnë dhe mbështesin jo vetëm gjitha Gjykatat e Kosovës, por edhe organet tjera dhe zyrtat publike mbi atë se si duhen interpretuar dhe aplikuar të drejtat dhe liritë themelore në Kosovë.

35. Përveç Kapitullit 2 "Të Drejtat dhe Liritë Themelore" si dhe Kapitullit 3 "Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre", ekzistojnë edhe dy ligje të cilat i ndihmojnë kësaj Gjykate në arritjen e Aktgjykimit në këtë rast. Ata janë Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve²⁵, si dhe Ligji mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre në Kosovë²⁶.
36. Qëllimi i Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve, siç është theksuar në terme të qarta, i jep vëmendje të veçantë gjuhëve të komuniteteve. Kjo ndodh edhe në nivelin komunal, duke autorizuar gjuhët e komuniteteve në përdorim zyrtar në kushtet e përcaktuara me ligj. Teksti i plotë i nenit 1 parashikon:

Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve

Neni 1

1.1. Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:

i. Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës, në ndërmarrje dhe organizata të tjera që realizojnë funksione dhe shërbime publike;

ii. Status të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, të drejta të barabarta sa i përket përdorimit të tyre në të gjitha institucionet e Kosovës;

iii. Të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor;

iv. Karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë kosovare, që paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore.

1.2. Në nivelin komunal, gjuhët e tjera të bashkësive, si gjuha turke, boshnjake dhe rome, do të jenë gjuhë në përdorim zyrtar, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

37. Gjykata i jep theks të veçantë formulimit të përdorur në nenin 1.1.iii, "të drejtat e gjitha komuniteteve në Kosovë për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor." Duke përdorur këtë formulim, Kuvendi ka zgjedhur t'i japë të drejtë të veçantë komuniteteve të promovojnë identitetin e tyre gjuhësor. Duhet bërë pyetja nëse Komuna e Prizrenit, në miratimin e saj të

²⁵ Ligji nr. 02/L-37 miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 korrik 2006

²⁶ Ligji nr. 03/L-047, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 mars 2008

nenit 7 të Statutit të saj, ka pasur parasysh këtë të drejtë. Kjo është sidomos e rëndësishme për shkak të pozitës së veçantë që Ligji i jep komuniteteve pakicë në Kosovë.

38. Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Anëtarëve të tyre në Kosovë është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 mars 2008. Dispozitat e përgjithshme në Nenin 1 dhe të drejtat në lidhje me identitetin në nenin 2 janë shprehje të fuqishme dhe të forta të vullnetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve pakicë dhe anëtarëve të tyre si qytetarë të Kosovës. Obligimet e Republikës së Kosovës për të njohur të drejtat e përcaktuara me këtë ligj nuk vlejnë vetëm për Qeverinë dhe Ministrinë e themeluara me Ligj. Ato vlejnë edhe për gjitha organet si dhe degët e Shtetit, duke përfshirë gjykatat dhe komunat.
39. Komunat janë njësi themelore e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, siç përcaktohet me nenin 124.1 të Kushtetutës: *"1. Njësia themelore e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë një shkallë të lartë të Vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrjen aktive të gjithë qytetarëve në procesin vendim-marrës të organeve komunale."* Komunat pra kanë njohje të veçantë në nivel kushtetues, si dhe të drejtat dhe obligimet përcjellëse sipas kornizës kushtetuese. Këto obligime përfshijnë obligimin për veprim në mënyrë kushtetuese në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë dhe ligj. Duke i dhënë komuniteteve dhe anëtarëve të tyre këto të drejta, si dhe duke pasur parasysh obligimet e gjithë organeve publike që të veprojnë në mënyrë të ligjshme dhe kushtetuese, duhet të bëhet një pyetje tjetër: nëse Komuna e Prizrenit ka marrë parasysh, apo ka marrë parasysh në masën e duhur, këto të drejta kur ka marrë vendimin për miratimin e nenit 7 të Statutit të saj.
40. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore, si dhe Protokollet e saj, siç është thënë më lart, janë inkorporuar brenda së drejtës në Kosovë në nivel kushtetues, dhe iu është dhënë prioritet mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike. Kjo Gjykatë duhet të interpretojë Kushtetutën dhe Konventën në mënyrë plotësuese, duke mbajtur mend domosdoshmërinë e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në të dyja. Shumë vende të Evropës që kanë dalë nga regjimet totalitare gjatë viteve të fundit kanë miratuar standarde evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kosova ka bërë të njëjtën gjë. Sistemi ynë është sistem i drejtësisë kushtetuese, i bazuar në parimet e barazisë, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe zbatimin e sundimit të ligjit.
41. Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është gjithashtu pjesë e së drejtës vendore të Kosovës, duke qenë një prej marrëveshjeve dhe

instrumenteve ndërkombëtare të përcaktuara me nenin 122. Nenet 1 deri në 6 të Konventës Kornizë i japin shprehje të fuqishme idealeve që janë themeli i arsyeve pse komunitetet pakicë duhet të kenë mbrojtje të veçantë. Ato theksojnë:

Neni 1

Mbrojtja e pakicave kombëtare dhe të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin këtyre pakicave përbën pjesë përbërëse të mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave njerëzore, dhe si e tillë bie në fushëveprimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Kornizë-Konvente do të zbatohen në mirëbesim, në frymën e mirëkuptimit dhe tolerancës, si dhe në pajtim me parimet e fqinjësisë së mirë, marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit mes shteteve.

Neni 3

- 1 *Secili person që i përket një pakice kombëtare do të ketë të drejtë të zgjedhë lirisht të trajtohet apo të mos trajtohet si i tillë, dhe asnjë pasojë nuk do të dalë nga kjo zgjedhje apo nga ushtrimi i të drejtave që lidhen me një zgjedhje të tillë.*
- 2 *Personat që i përkasin pakicave kombëtare mund të ushtrojnë të drejtat dhe gëzojnë liritë që dalin nga parimet e kësaj Kornizë-Konvente, individualisht si dhe në bashkësi me të tjerë.*

Neni 4

- 1 *Palët marrin përsipër t'i garantojnë personave që i përkasin pakicave kombëtare të drejtën e barazisë para ligjit dhe të mbrojtjes së barabartë para ligjit. Në këtë kuptim, ndalohet diskriminimi në bazë të përkatësisë në një pakicë kombëtare.*
- 2 *Palët marrin përsipër të miratojnë, kudo që është e nevojshme, masat adekuate për të promovuar, në gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore, barazinë e plotë dhe efektive mes personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës. Në këtë kuptim, ato do të marrin parasysh kushtet specifike të personave që i përkasin pakicave kombëtare.*
- 3 *Masat e miratuara në pajtim me paragrafin 2 nuk do të konsiderohen të jenë vepër diskriminimi.*

Neni 5

- 1 *Palët marrin përsipër të promovojnë kushtet e domosdoshme për personat që i përkasin pakicave kombëtare të ruajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre, si dhe të mbrojnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, gjegjësisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore.*
- 2 *Pa paragjykuar masat e marra në pajtim me politikat e tyre të përgjithshme të integritetit, Palët do të përmbahen nga politikat apo praktikave që synojnë asimilimin e personave që i përkasin pakicave kombëtare pa vullnetin e tyre, si dhe do të mbrojnë ata persona nga çdo veprim që synon një asimilim të tillë.*

Neni 6

- 1 *Palët do të inkurajojnë frymën e tolerancës dhe dialogut ndër-kulturor, si dhe do të marrin masa efektive për të promovuar respektin e ndërsjellë dhe mirëkuptimin e bashkëpunimin mes gjithë personave që jetojnë në territorin e tyre, pa marrë parasysh identitetin etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar të këtyre personave, e sidomos në fushat e arsimit, kulturës dhe medie.*
 - 2 *Palët marrin përsipër të marrin masat e duhura për të mbrojtur personat që mund t'i nënshtrohen kërcënimeve apo akteve të diskriminimit, armiqësisë apo dhunës si rezultat i identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.*
42. Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve dhe Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe anëtarëve të tyre në Kosovë, në një masë të madhe i kanë dhënë efekt konkret Konventës Kornizë. Gjykata do të interpretojë veprimet e Komunës së Prizrenit në dritën e Kushtetutës, Konventave Ndërkombëtare të inkuorpuara në të drejtën e Kosovës, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe këto ligje.
43. Prizreni gjendet në jug të Kosovës dhe për shkak të pozitës së tij gjeografike është qendër e rëndësishme komerciale dhe afariste. Ai ka histori të gjatë dhe traditë të larmisë etnike. Është i pasur në kultura, e aq më shumë për shkak të larmisë dhe heterogjenitetit etnik të popullsisë së tij. Prizreni ka traditë të gjatë të bashkëpunimit dhe tolerancës mes komuniteteve të tij të ndryshëm. Komuna e Prizrenit ka anëtarë nga komunitetet e ndryshme, si dhe parashtruesi, Z. Kurtishi, është Zëvendës Kryesues për Komunitete i Komunës.
44. Ankesa e veçantë në këtë rast ka të bëjë me simbolin e Komunës së Prizrenit. Simbolet janë afërsisht të lidhura me nxitjen dhe ruajtjen e traditës,

kulturës, karakteristikave të veçanta të secilit komb, si dhe kanë ndikimin në grumbullimin dhe bashkimin rreth një ideje dhe një besimi. Nuk ka kurrfarë dyshimi që simbolet përçojnë disa emocione dhe kuptime të cilat përjetohen në mënyra të veçanta nga ata që gjejnë historinë, traditën dhe kulturën e tyre në ato simbole. Simbolet nuk janë fotografi e dekorime të pastra, por secili përmban një kuptim të caktuar më të thellë dhe të fshehtë.

45. Emblema përfaqëson në shumë mënyra arritjet, shpresën dhe idealet e gjithë qytetarëve të një vendi apo të një rajoni të një vendi. Si e tillë, emblema duhet të respektojë gjithë qytetarët, që në këtë rast janë qytetarët e Komunës si "njësi themelore territoriale e Vetëqeverisjes lokale e Republikës së Kosovës"²⁷. Për ta bërë mundur që qytetarët e Prizrenit ta shohin dhe ta ndjejnë atë në këtë mënyrë, emblema e Komunës do të duhej të ishte simbol i gjithë qytetarëve.
46. Nuk është vetëm simboli lokal i vetëm një komuniteti ai që duhet reflektuar në traditën dhe trashëgiminë historike të atij populli, por simboli zyrtar duhet të reflektojë natyrën shumetnike të Komunës. Kjo Gjykatë është e vetëdijshme që shqiptarët identifikohen me "1878"-shin e shkruar në emblemën e Komunës së Prizrenit, ashtu siç thuhet me nenin 7 të Statutit të Komunës. Viti 1878 ka qenë viti i themelimit të Lidhjes së Prizrenit. Udhëheqësit shqiptarë u mbledhën në Prizren, më 10 qershor të atij viti, duke kërkuar të arrijnë shtetin e pavarur shqiptar. Asnjë njeri në Prizren nuk mund të dyshojë se përfshirja e vitit "1878" mëtonte të favorizojë komunitetin shqiptar duke përjashtuar komunitetet joshumicë. Gjykata ka qëndrimin që komunitetet tjera në Komunën e Prizrenit kanë të drejtën legjitime të ruajnë traditën, kulturën dhe identitetin e tyre përmes Emblemës. Kur Komuna ka vendosur të shpallë emblemën që promovon trashëgiminë dhe traditën shqiptare pa vëmendje ndaj komuniteteve tjera, ajo ka shkelur të drejtat e tyre statusore dhe kushtetuese.
47. Gjykata Kushtetuese përsërit se e drejta e Komuniteteve për ta shprehur lirshëm, përkujdesur dhe zhvilluar identitetin e tyre dhe atributet e komunitetit i përket të gjitha komuniteteve në Kosovë. Në të vërtetë, si shqiptarët ashtu edhe komunitetet tjera duhet të jenë në gjendje që njëlloj ta ruajnë traditën, kulturën dhe identitetin e tyre përmes simboleve përkatëse. Mbrojtja e duhur e këtyre të drejtave të komuniteteve padyshim dhe në mënyrë të qenësishme shfaqin nevojën për një veprim të bashkërenduar, koherent dhe mbështetur nga ana e autoriteteve publike që synon të ofrojë mundësi të barabarta dhe një varg të drejtash kulturore, gjuhësore dhe të drejta të tjera për të gjitha komunitetet.²⁸

²⁷ Neni 12 (1) i Kushtetutës

²⁸ Shih p.sh. Raporti i Komisionit të Venedikut mbi të Drejtat e Joshtetasve dhe Pakicave të miratuar në Komisionin e Venedikut në seancën plenare të 69-të (Venedik, 15-16 dhjetor 2006).

48. Veç kësaj, Konventa Kornizë për Mbrojtjen e të Drejtave të Pakicave Kombëtare thekson se *"një shoqëri pluraliste dhe vërtetë demokratike nuk të respektojë vetëm identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo personi që i përket një pakice, por gjithashtu edhe të krijojë kushtet e duhura që i mundësojnë atyre të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë këtë identitet."*²⁹
49. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu përkujton se Kushtetuta përcakton se *"Republika e Kosovës është shoqëri shumëetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera"*³⁰ dhe në mënyrë të barabartë garanton të drejtat e komuniteteve në shfrytëzimin dhe shfaqjen e simboleve të komuniteteve, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Kushtetuta³¹ më tutje përcakton përgjegjësinë e Shtetit për të siguruar kushte të duhura që i mundësojnë komunitetet dhe pjesëtarët e tyre për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identiteteve të tyre; po ashtu, ajo thekson përgjegjësinë e Shtetit në promovimin e frymës së tolerancës dhe dialogut, si dhe mbështetjen e pajtimit ndërmjet komuniteteve.
50. Prandaj, Gjykata Kushtetuese duhet të merr parasysh se në çfarë niveli neni 7 i Statutit Komunal të Prizrenit është në pajtueshmëri me këto standarde duke krijuar kushte të duhura që i mundësojnë të gjitha komunitetet që të ruajnë identitetin e tyre nën një simbol të përbashkët, d.m.th. emblemën e Komunes së Prizrenit.
51. Megjithatë, duhet se komuniteti shqiptar është vendosur në një pozitë të privilegjuar jo vetëm sepse ky komunitet përbën shumicë të dalluar në Kuvend dhe ka pozitë dominuese në Komunë. Gjykata konsideron se Kuvendi Komunal i Prizrenit nuk i ka trajtuar si duhet shqetësimet e shprehura nga parashtuesi i kërkesës. Në të vërtetë, parashtuesi i kërkesës mban qëndrimin se deputetët e Kuvendit Komunal të komunitetit shumicë kanë injoruar praninë tradicionale të komuniteteve joshumicë në Komunë.³²
52. Gjykata Kushtetuese konsideron se pjesëmarrja e komunitetit në jetën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore³³ është parakusht për një shoqëri pluraliste dhe vërtetë demokratike, qoftë në një shtet, rajon, komunë, apo njësi tjetër territoriale, në mënyrë që të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të kenë interes në atë shoqëri. Kjo pjesëmarrje nuk mund të arrihet nëse simboli i përbashkët i asaj shoqërie nuk përfaqëson të drejtat e të gjitha komuniteteve, por, në vend të kësaj, injoron të drejtat e komuniteteve joshumicë.

²⁹ Shih Preambulën e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

³⁰ Shih nenin 3 të Kushtetutës

³¹ Shih nenin 58

³² Shih paragrafin 12 të Aktgjykimit

³³ Cf. Neni 15 i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

53. Si rrjedhojë, emblema e Komunës së Prizrenit, që përbëhet nga shprehja më e fuqishme e identitetit të të gjitha komuniteteve, duhet të paraqesë simbolin e shoqërisë shumetnike, duke përfaqësuar komunitetin shumicë dhe ato joshumicë, si dhe duhet të promovojë një frymë të tolerancës, dialogut dhe pajtimit ndërmjet komuniteteve.
54. Gjykata përkujton propozimin e komuniteteve joshumicë në Prizren se formulimi "Komuna", "Opstina", "Belediye" të shkruhet brenda rrethit të emblemsë së Komunës pa vitin "1878". Gjykata është e mendimit se ky ishte propozim i arsyeshëm i cili do të mund t'i përmbushte shqetësimet legjitime të komuniteteve.
55. Në përputhje, Gjykata konstaton se Kuvendi Komunal, gjatë marrjes së vendimeve për miratimin e nenit 7 të këtij Statuti, ka imponuar një emblemë e cila nuk mund të konsiderohet si simbol i përbashkët i të gjitha komuniteteve të Prizrenit, dhe në këtë mënyrë i ka dhënë rëndësi më të madhe Komunitetit Shqiptar mbi identitetit të komuniteteve tjera në Prizren. Prandaj, Gjykata konstaton se Kuvendi Komunal ka bërë shkelje të Kushtetutës.
56. Duke pasur gjitha këto parasysh, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe të drejtës në rastin konkret, obligimet e Komunës për marrë në konsideratë të drejtat e komuniteteve joshumicë, nenet e Kushtetutës të referuara ndaj Konventave Ndërkombëtare dhe praktikës gjegjëse gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata ka ardhur në konkludimin që Komuna e Prizrenit, kur ka marrë vendim për miratimin e nenit 7 të Statutit të saj, nuk ka pasur vëmendjen e duhur, apo nuk ka pasur aspak vëmendje ndaj të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë në trajtimin e të drejtës së komuniteteve pakicë për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre.

Dispozitivi

57. Për këtë arsye Gjykata jep Aktgjykimin njëzëri, me mendimin konkurrues të Gjyqtarit Rodrigues, si në vijim;
1. **Merr vendim** se kërkesa është e pranueshme
 2. **Konstaton** se është bërë shkelje e të drejtave të komuniteteve joshumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre
 3. **Vendos** se neni 7 i Statutit të Komunës së Prizrenit nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), në veçanti nenet 3, 7.1, 58 dhe 59
 4. **Urdhëron** Komunën e Prizrenit që, brenda një periudhe prej tre muajsh nga dorëzimi i këtij Aktgjykimi, të ndryshojë Statutin dhe emblemën e saj

në mënyrë që ta sjellë ato në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe të mos përjashtojë komunitetet joshumicë

5. **Kërkon** nga Komuna e Prizrenit t'i raportojë Gjykatës mbi përparimin në lidhje me pajtueshmërinë me atë Urdhër, para skadimit të periudhës së tre muajve prej dorëzimit të atij Gjykimi, dhe
6. **Mbetet e angazhuar** fuqimisht për çështjen në pritje të pajtueshmërisë me atë Urdhër

Ky Aktgjykim do të ketë efekt të menjëhershëm prej dorëzimit të tij tek palët.

Nxjerrë në Prishtinë, po këtë ditë të marsit 2010.

Gjyqtari Raportues

Kryetari i Gjykatës

Judge Almiro Rodrigues, d.v.

Prof. Dr. Enver Hasani, d.v.

